

MASTER I SHKENCAVE NË “INXHINIERI NDËRTIMI”

(programi ofrohet me dy profilet: a. Inxhinieri Strukturash dhe b. Infrastrukturë Transporti)

OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Programi i studimit Master në “Inxhinieri Ndërtimi” ka për qëllim të përgatisë profesionistë të kualifikuar, të aftë për të adresuar sfidat komplekse dhe avancuara në fushën e inxhinierisë së ndërtimit. Ky program përfshin njohuri teorike dhe praktike në projektimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e strukturave dhe veprave inxhinierike. Nëpërmjet këtij programi, studentët do të zhvillojnë aftësi analitike dhe kritike, të cilat do t'u lejojnë të zgjidhin problemet teknike dhe shkencore në mënyrë inovative.

REZULTATET E TË NXËNIT

Në përfundim të programit studenti do të jetë i aftë të:

- Hartojë dhe zbatojë standardet e ndërtimit, duke u fokusuar në proceset e përshtatjes dhe respektimit të ligjeve dhe kodeve të sigurisë për të garantuar cilësinë e punimeve.
- Planifikojë dhe koordinojë burimet e ndërtimit, duke përfshirë menaxhimin e buxhetit dhe kohës, për të siguruar realizimin e suksesshëm të projekteve.
- Analizojë dhe zgjedhin materialet e duhura për ndërtim, duke marrë parasysh karakteristikat e tyre fizike dhe kimike në procesin e projektimit.
- Bashkëpunojë në një ekip me profesionistë të tjerë, duke kuptuar rëndësinë e komunikimit dhe koordinimit në projekte komplekse.
- Propozojë dhe argumentojë zgjidhat më të përshtatshme të probleme inxhinierike që shfaqen gjatë ciklit të jetës së një projekti ndërtimi, duke aplikuar teknika të ndryshme për identifikimin dhe zgjidhjen e tyre.
- Vlerësojë dhe menaxhojë rreziqet që lidhen me projektet ndërtimore, duke përgatitur strategji për të minimizuar ndikimet negative.
- Promovojnë përdorimin e praktikave dhe teknologjive të qëndrueshme në ndërtim, duke kontribuar kështu në ruajtjen e mjedisit.

PROFILI: INXHINIERI STRUKTURASH

- Projektojnë struktura speciale prej betoni të armuar si, mure mbajtësi, bunkera, silosa, rezervuare, oxhaqe, tubacione etj.
- Aplikojë përdorimin e metodave të avancuara të analizës, për të simuluar sjelljen e strukturave nën ngarkesa të ndryshme statike dhe dinamike/sizmike dhe kushte mjedisore të jashtme.
- Analizojë dhe projektojnë zgjidhje në lidhje me restaurimin dhe përforcimin e strukturave ekzistuese, duke u bazuar në normat evropiane, për të siguruar optimizim të qëndrueshmërisë dhe sigurisë së strukturave.

PROFILI: INFRASTRUKTURË TRANSPORTI

- Modelojnë dhe analizojnë veprat infrastrukturore të transportit, si dyshemetë e rrugëve dhe traseve hekurudhore, duke ndjekur standardet e nevojshme për siguri dhe efikasitet.
- Projektojnë veprat e veçanta si, rrugë, ura, tunele, tombino etj., duke siguruar që të gjitha projektet të jenë të zbatueshme dhe në përputhje me standardet inxhinierike.
- Propozojë dhe miratojnë zgjidhjet e duhura gjatë zbatimit të veprave inxhinierike të infrastrukturës së transportit, duke përdorur qasje inovative për të përmirësuar efikasitetin.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi" u jep mundësi studentëve të punësohen si inxhinierë, sipas njohurive dhe kompetencave të fituara në:

- Inxhinier projektues në kompani të ndërtimit, zhvillues të njohur të pasurive të patundshme dhe agjenci ndërtimi.
- Ekspertë në ndërtim në firma të specializuara të ndërtimit, kompani konsultimi dhe institucione që ofrojnë shërbime të avancuara të mbikëqyrjes.
- Inxhinier i performancës së materialeve në kompani prodhuese inovative, si dhe në laboratorë hulumtimi që promovojnë standardet e larta të performancës.
- Drejtues teknik në kompani dhe institucione që ofrojnë konsulencë strategjike për sigurinë në punë.
- Inspektorë të ndërtimit për mbikëqyrje dhe supervizim të kualifikuar në projekte të ndërtimit.
- Inxhinier ndërtimi i strukturave në kompani projektimi dhe zbatimi, studio inxhinierike dhe institucione publike, duke kontribuar në analizën dhe projektimin e strukturave prej betoni të armuar, çeliku, druri dhe materialeve të tjera ndërtimore për ndërtesa civile, industriale dhe vepra inxhinierike.
- Specialist i projektimit të strukturave në projekte të ndërtimit, restaurimit dhe përforcimit të ndërtesave, duke realizuar analiza strukturore, sizmike dhe përcaktimin e performancës së strukturave.
- Inxhinier i analizës dhe vlerësimit strukturor në kompani konsulencë, institucione teknike dhe organizata të specializuara, duke kryer ekspertizë teknike, vlerësime të gjendjes së strukturave ekzistuese, si dhe kontrole të përputhshmërisë me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të projektimit.
- Inxhinier ndërtimi i infrastrukturës së transportit në kompani ndërtimi, autoritete lokale të transportit dhe agjenci qeveritare, duke kontribuar në planifikimin dhe zhvillimin e infrastrukturës së qëndrueshme dhe efikase për përmirësimin e transportit dhe lëvizshmërisë.
- Specialistë të infrastrukturës në projekte të menaxhimit të ndërtimit, zhvillimin e rrugëve dhe sistemet e transportit publik, si dhe bashkëpunimin me autoritete të ndryshme.
- Inxhinier i planifikimit të infrastrukturës së transportit në agjenci qeveritare dhe kompani të specializuara në studime të fizibilitetit, ndikimit mjedisor dhe projektimin strategjik të rrugëve dhe infrastrukturën.

Mbajtësi i diplomës gëzon të drejtën të pajiset me licencë referuar kuadrit ligjor në fuqi, për të kryer shërbime dhe këshillim teknik ndaj subjekteve publike apo private, si profesionistë i lirë në fushën e inxhinierisë së ndërtimit (në rolin e inxhinierit, përgjegjësit të sektorit ose drejtuesit teknik në projektimin e strukturave dhe veprave infrastrukturore).

MSH "INXHINIERI NDËRTIMI" 120 ECTS

Nr.	Viti	Sem	Emri i lëndës	ECTS
-----	------	-----	---------------	------

A - Lëndë Bazë/ 10% /6 ECTS

1	II	1	Metoda kërkimi në inxhinieri	6
---	----	---	------------------------------	---

B- Lëndë Karakterizuese të Programit 50%-60%/60 ECTS

1	I	1	Teoria e avancuar e strukturave 1	6
2	I	2	Teoria e avancuar e strukturave 2	6
3	I	1	Konstruksione Speciale Beton Arme	8
4	I	2	Dinamika e strukturave dhe inxhinieria sizmike	6
5	I	1	Projektim Urbanistik 1	6
6	I	2	Ura dhe Tunele	6
7	I	1	Mekanika e Dherave, Shkembit dhe Themeleve	10
8	II	1	GIS	6
I. Profili:			INFRASTRUKTURË TRANSPORTI	
9	I	2	Gjeologjia e Aplikuar	6
II. Profili:			INXHINIERI STRUKTURASH	
9	I	2	Konstruksione Beton Arme të paranderura	6

C -LËNDË NDËRDISIPLINORE / INTEGRUESE 12-20%/ 14 ECTS

I. Profili:			INFRASTRUKTURË TRANSPORTI	
1	I	2	Hartografi	6
2	II	1	Dyshemetë rrugore, hekurudhore dhe aeroportuale	8
II. Profili:			INXHINIERI STRUKTURASH	
1	I	2	Normativa dhe projektimi i elementëve të strukturave Beton-Arme	6
2	II	1	Restaurimi dhe përforcimi i strukturave	8

Lëndë me zgjedhje

3	II	1	E drejtë mjedisi	8
---	----	---	------------------	---

D- LËNDË PLOTËSUESE / 10% / 12 ECTS

1	II	1-2	Praktikë profesionale	12
---	----	-----	-----------------------	----

E - DETYRIME PËRMBYLLËSE/ 10%-25% / 28 ECTS

1	II	2	Punimi i diplomës	28
---	----	---	-------------------	----

Totali 120